

ANILA OMARI

FILOLOGJIA E TEKSTEVE SHQIPE DHE ZHVILLIMI I SAJ DERI NË DITËT TONA: VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Studimet filologjike tekstuale shqiptare kanë një traditë të vonë zhvillimi, dhe kjo ka arsyet e veta¹, ku në radhë të parë rendisim fillesat relativisht të vona të shkrimit shqip. Këtë gjendje e pati vënë re në kohën e tij filologu i shquar francez Mario Roques (Rok), i cili shprehej se, ndërsa studimet gjuhësore shqiptare kanë ecur përpara, filologjia shqipe, përkundrazi, është ende në fillimet e veta. Me këtë rast ai paraqet konceptin e tij për termin “filologji shqipe”, si njohja, leximi, interpretimi dhe vënia në përdorim e teksteve shqipe dorëshkrime apo shtypshkrime, të cilat, duke pasqyruar gjendje gjuhësore të mëhershme, do të ndihmonin për të kuptuar më mirë gjuhën e gjallë; do të shërbenin si udhërrëfyes apo verifikues për rindërtimin e zhvillimit historik të gjuhës; dhe më në fund gjuha e shkruar do të linte një gjurmë të re edhe në gjuhën e folur, sado primitive të jetë ajo². Këtu duam të ndalemi pak për të sqaruar konceptin “filologji” në gjuhësinë tonë. Siç shihet M. Roku i dallon konceptet studime gjuhësore dhe studime filologjike, sipas kuptimit që ka ky term i fundit në disa vende të Evropës Perëndimore, si Francë e Itali, ku emërtimi i disiplinës lidhet gjithmonë me studimin e dokumenteve shkrimore, pra me tekstin (1. disiplinë që studion dokumentet gjuhësore dhe letrare të një kulture të caktuar ose të një qytetërimi të caktuar letrar, dhe përmes shqyrtimit të teksteve, dokumenteve e dëshmive, përpiqet të japë një interpretim të saktë të një problemi kritik e historik; 2. shkenca dhe teknika që ka si synim të rindërtojë një tekst në formën e tij origjinale), por jo në Angli apo Gjermani, ku termi është një koncept i përgjithshëm për të gjitha shkencat gjuhësore dhe letrare³. Tek ne ka mbizotëruar koncepti gjermanorus, i përdorur edhe në vendet e tjera të Lindjes, dhe në këtë kuptim kemi edhe emërtimin e Fakultetit Filologjik, revistën Studime filologjike etj. Ky kuptim

¹ Një paraqitje të gjendjes së botimeve kritike në Shqipëri me përpjekje edhe për analizimin e shkaqeve të prapambetjes në këtë fushë ka bërë Merita Bruci, “Botimet kritike në Shqipëri – misioni i papërmbushur i filologjisë shqipe”, në: *Studi sull’Europa Orientale*, a cura di I.C. Fortino – E. Çali, Napoli, 2007, f. 403-416.

² M. Roques, *Le dictionnaire albanais de 1635*, Paris, 1932, f. 7-9.

³ Shih p.sh. Fjalori i anglishtes i Oxford-it: “Dega e dijes që merret me strukturën, zhvillimin historik dhe marrëdhëniet e një gjuhe ose të gjuhëve”, Fjalori i gjermanishtes Wahrig: “Shkenca gjuhësore dhe letrare” (Sprach- und Literaturwissenschaft).

është pasqyruar edhe në fjalorët e shqipes. Sipas FGJSSH, filologjia është “Tërësia e shkencave që studiojnë gjuhën dhe krijimtarinë letrare të një populli”, dhe ky është edhe kuptimi mbizotërues në shqipen e sotme. E shtrova këtë çështje, jo vetëm se lidhet drejtpërdrejt me temën e shkrimit, por edhe për shkak të diskutimit që u hap në Institutin e Gjuhësisë për këtë term me rastin e thirrjes për konferencën kushtuar 50 vjetorit të revistës Studime filologjike. Ç’është e vërteta, në përkufizimet e sotme të konceptit “filologji” në fjalorët e internetit ose në enciklopeditë online po anohet nga kuptimi i gjuhëve neolatine si kuptim i parë, pra “shkencë që studion tekstet letrare ose regjistrimet e shkruara, përcaktimin e autenticitetit të tyre dhe formës së tyre origjinale dhe përcaktimin e kuptimit të tyre”, ndërsa kuptimi “gjuhësi” ka kaluar në plan të dytë, si përdorim i vjetruar. Edhe në rrethet shkencore albanologjike ka hyrë në përdorim ky kuptim i termit “filologji”, sidomos me disa botime të tipit filologjik-tekstual mbas viteve ’90, çka shtron ndoshta edhe nevojën për të përfshirë në fjalorët e rinj të shqipes një kuptim të dytë të lemës “filologji”.

Nëse hedhim një vështrim të shkurtër historik për filologjinë shqipe, mund t’i gjenim fillesat e saj në vitin 1743, me zbulimin e ‘Mesharit’ të Gjon Buzukut nga Gjon Nikollë Kazazi dhe riprodhimin diplomatik prej tij të dy copave teksti në letrën drejtuar Atë Gjergj Guxetës, drejtuesit të Seminarit të Palermos. Saktësoj vitin 1743, dhe jo 1740 siç është mbajtur deri vonë, duke u mbështetur në studimet e fundit të Bardhyl Demirajt mbi jetën dhe veprën e Kazazit, sipas të dhënave burimore të gjetura në arkivin e Propagandës Fide⁴. Zbulimi i ‘Mesharit’ mund të shtyhet më tej në kohë, në vitet 1716-1726, në qoftë se pranojmë, me B. Demirajn, që “dorëshkrimi ritual në gjuhën tonë” (N. Keta) i kopjuar prej imzot Filoteo Zassit nga origjinali i Propagandës dhe i hartuar prej Donich Buzukut është pikërisht kopjim nga “Meshari”⁵. Duhet të kalojmë dy shekuj që nga ajo kohë që të kemi disa përpjekje botimesh filologjike pas rizbulimit të ‘Mesharit’ në vitin 1909 nga Pal Skiroi, këtë radhë në bibliotekën e Vatikanit. Ky studiues pas një pune shumëvjeçare përgatiti edicionin e plotë kritik të tekstit me transliterim e transkriptim fonetik dhe me një studim për gjuhën e autorit, krahasuar me gjuhën e

⁴ Khs. B. Demiraj, Zur Entdeckung von Buzukus “Missale” in der ersten Hälfte des 18. Jh.s, në: “Nach 450 Jahren. Buzukus Missale und seine Rezeption in unsere Zeit”, Akten der 2. Deutsch-Albanischen Kulturwissenschaftlichen Tagung in München - 14.-15. Oktober 2005, në serinë “Albanische Forschungen” vëll. 25, Wiesbaden 2007, f. 289 – 299.

⁵ Shih B. Demiraj, “Një dorëshkrim ritual në gjuhën tonë” që duhet kërkuar, *Hylli i Dritës*, nr. 1, 2007. Shkodër, f. 30-37.

shkrimtarëve të tjerë të Veriut⁶. Për fat të keq kjo vepër deri sot ka mbetur pa botuar ndërsa kohët e fundit studiuës arbëreshë kanë bërë përpjekje sensibilizuese ndaj shtetit shqiptar për mundësimin e botimit të saj. Megjithatë Pal Skiroi në fillim të viteve '30 arriti të botojë pjesët biblike nga "Meshari", në transkriptim interpretues fonetik me shënime e vërejtje gramatikore, në bashkëpunim me Gaetano Petrottën, i cili hartoi studimin hyrës dhe bëri transkriptimin diplomatik të tekstit⁷. Në të njëjtën kohë në dheun amë të "Mesharit" u ndërmorën nisma editoriale për librin e parë shqip i cili ndërkohë kishte mbërritur në Shqipëri i porositur nga françeskanët shqiptarë.

Gjatë kësaj kohe librit iu bë një përshkrim bibliografik me vërejtje teorike rreth autorit e veprës së tij nga Mario Roques në punimin: *Recherches sur les anciens textes albanais*, Paris, 1932.

Studiuësit arbëreshë, gjithmonë një hap para për sa u përket botimit të autorëve të tyre, kishin filluar që më 1912 me botimin kritik të katekizmit të Lekë Matrangës *E mbsuame e krështerë* nga Marco La Piana⁸.

Për botimet e fragmenteve dorëshkrimore parabuzukiane do të flasim më poshtë, por në këtë periudhë të viteve '30 shohim interes edhe për botimin e tyre, p.sh. nga Nilo Borgia, murg i Grottaferratës, apo F. Ribezzo, gjuhëtar i njohur italian me ndihmesa të rëndësishme për albanologjinë.

Në dhjetëvjeçarët e parë të shekullit XX duhet të përmendim kontributin e revistave kulturore-letrare shqiptare në studimet filologjike shqiptare, sidomos të "Hyllit të Dritës", por edhe "Fjala e T'In Zoti" e "Zani i Shën Ndout" të Shkodrës, "Tomori" e "Kopështi letrar" të Elbasanit etj.

Revista "Hylli i Dritës" meriton një vështrim më të thelluar për ndihmesën e saj në studimet filologjike të teksteve të vjetra shqipe. Ajo drejtohej nga françeskanët, të cilët, si vijuesit e veprës së autorëve të vjetër, ishin më të interesuarit për botimin e njohjen e teksteve të tyre nga lexuesi bashkëkohës. Kjo bëhej edhe në funksion të studimit të gjuhës së tyre për të nxjerrë përfundime shkencërisht të sakta për gjuhën e përbashkët letrare.

Që në vitin 1914 në këtë revistë shtrohet një kërkesë për botimin kritik të veprës së Bogdanit sipas parimeve korrekte filologjike nga Atë Pashk Bardhi, kur shkruan: "Aj meshtaar i Shqypniës qi, tuj kë në i themeluem mirë n'gjuhë shqype, t'a qesë n'dritë librin e Bogdanit me drejtshkrojë t'soçme, paa ja

⁶ Khs. E. Çabej, "Hyrje" në: "Meshari" i Gjon Buzukut (1555). *Botim kritik, Pjesa e parë – Hyrje dhe transliterim*, Tiranë, 1968, f. 7.

⁷ Në *Rivista indo-greco-italica*, XVI/1, 1932.

⁸ M. La Piana, *Il catechismo albanese di Luca Matranga (1952)*, në: *Roma e l'Oriente, Rivista criptoferratense per l'unione delle Chiese*, viti II, vëll. III, prill 1912, Badia Greca di Grottaferrata; viti II, vëll. IV, maj-tetor 1912; Po ai, *Il catechismo albanese di Luca Matranga (1952), da un antico manoscritto vaticano*, Grottaferrata, 1912.

ndrrue aspak giuhën, veç tuj e stolisë e zbukurue me oroe t'veta, kishte me i bâa një sherbim të madh fees katolike e leteratueres shqype.”⁹. Në atë kohë nuk përmendej ende libri i Buzukut, megjithëse Imzot Pal Skiroi e kishte (ri)zbuluar që në vitin 1909 dhe njoftimi i parë ishte bërë po atë vit nga gazeta “Dielli” e Amerikës, rimarrë nga gazeta “Tomori” e Elbasanit dhe “Lirija” e Kristo Luarasis në 1910. Mbas përfundimit të trazirave të luftës botërore Pal Skiroi, i cili që nga çasti i zbulimit të librit kishte punuar për transliterimin e tij, njofton se është gati të botojë veprën e Buzukut, nëse siguron një numër të caktuar pajtimtarësh për të përballuar shpenzimet e shtypit. Thirrjes së Imzotit iu përgjigjën menjëherë, në vitin 1919, fletorja “Kuvendi” që dilte në Romë nën drejtimin e Sotir Gjikes¹⁰, “Fjala e T’In Zoti” në po këtë vit e “Zani i Shën Ndout” në numrin II të vitit 1920, kur “Hylli” ishte përkohësisht i mbyllur. “Hylli i Dritës” mbasi rifillon veprimtarinë botuese në vitin 1921, ndihmon shumë në përhapjen e njoftimit për “Mesharin” duke dhënë një përshkrim të librit e të përmbajtjes së tij, historikun e zbulimit, alfabetin dhe transliterimin e një cope nga Kënga e Zakarisë profetë¹¹. Njëkohësisht ai paralajmëron daljen e tekstit të Buzukut të transliteruar në alfabet të sotëm, shoqëruar me përkthimin në italisht dhe riprodhimin fototipik të origjinalit, dhe me njoftimin për pajtimtarët. Më pas iniciativën e merr në dorë Atë Shtjefën Gjeçovi i cili boton një shpallje për pajtim në veprën që kishte bërë gati Pal Skiroi, duke botuar edhe letrën e Skiroit drejtuar shqiptarëve për ta ndihmuar në botimin e librit, në të cilën premtonte edhe botimin e fjalorit të plotë të tekstit dhe një gramatikë. Menjëherë mbas kësaj thirrjeje thuhet çdo numër i revistës gjatë dy viteve, 1921-1922, boton nga një listë pajtimtarësh e cila më në fund e plotëson numrin prej 100 vetash. Megjithatë Skiroi nuk kishte as mundësitë për blerjen e letrës, kështu që vepra e tij mbeti në dorëshkrim dhe ende sot pret dritën e botimit.

Që nga ajo kohë revista dhe françeskanët nuk reshtën së interesuari për librin e parë shqip. Dom Nikollë Gazulli shkruan në vitin 1924, nr. VII, “Gjurmime mbi veprën e Dom Gjon Buzukut” duke sjellë të dhëna me interes, për atë kohë të panjohura gjerësisht, për shkrimin e shqipes shumë kohë para Buzukut apo për gjurmët e emrit Buzuk në Bosnjë dhe shtron problemin filologjik të kërkimit të dorëshkrimit origjinal të Buzukut.

Por ai që ka meritat e dorës së parë për ardhjen e “Mesharit” në Shqipëri dhe studimin e tij është Atë Justin Rrota, studiuesi që mban peshën kryesore

⁹ Vorf Dukagjini, “Perdorimi i ë n’shkrim t’giuhës shqype”, *HD*, I (1914), nr. 8, f. 242 shën. 3.

¹⁰ D. N. Gazulli, “Gjurmime mbi veprën e Dom Gjon Buzukut”, *HD*, V (1924), nr. 10, f. 434.

¹¹ “Biblijografi. Libri i Dom Gjon Buzukut, i shtypun në vjetë 1555”, *HD*, II (1921), nr. VII, f. 330-332.

në kontributin e “Hyllit të Dritës” si në çështjet e gramatikës ashtu edhe të filologjisë shqipe. Me përpjekjet dhe interesimin e tij këmbëngulës etërit françeskanë kërkuan në Ministrinë e Arsimit të merrnin nga Vatikani tekstin e fotografuar të Buzukut në tri kopje, të cilin u ngarkua ta sjellë në atdhe pikërisht Atë Justinini në vitin 1929¹². Kopjen që iu dhurua Bibliotekës Françeskane Justin Rrota e mori menjëherë në studim dhe pa u mbushur viti filloi botimin në 6 numra të revistës të disa pjesëve të “Mesharit”, të cilat më pas i përmbloodhi në një fashikull “Monumenti mâ i vjetri i Gjuhës Shqype. D. Gjon Buzuku (1555)”¹³. Punimi shoqërohej me një hyrje ku, përpos përshkrimit fizik të vëllimit, jepeshin të dhëna për autorin dhe vendin e botimit, lëndën e librit, grafinë dhe gjuhën e tekstit. Pjesët që zgjodhi për botim, disa copa biblike të stilit narrativ, ai i riprodhoi në transliterim besnik dhe në një transkriptim në alfabetin e sotshëm, sipas përfytyrimit të tij se si mund të lexohej Buzuku, prandaj në shumë pika transkriptimi është më fort një përshtatje në gegërishten e kohëve të reja. Pjesët e botuara shoqërohen me shënime e komente gjuhësore shumë të vlefshme për historinë e gjuhës shqipe e të dialekteve të saj. Artikulli i numrit të fundit përmban copa të krahasuara të lutjes Ati ynë, Falemi Mëri dhe Besoj nga Buzuku, Matranga, Budi e Kazazi.

Në të njëjtin vit 1930, numri 3, revista boton mendimet e dy gjuhëtarëve të huaj për librin e Buzukut: një intervistë me akademikun nga Beogradi Jovan Tomić, i cili jep mendime rreth vendit të mundshëm të botimit përtej Adriatikut, dhe një studim të shkurtër e të rëndësishëm nga N. Jokli për disa probleme themelore të grafisë së Buzukut dhe të vetë autorit¹⁴, të cilat edhe sot mbeten objekt diskutimi për studiuesit buzukianë.

Në vijim të interesit për tekstet e vjetra dhe fillimet e shkrimit shqip Justin Rrota boton dy studime mbi tekstet më të vjetra në dialektin e Jugut. I pari është studimi për dorëshkrimin toskërisht të Ungjillit të Pashkëve, me rastin e botimit të tij nga Nilo Borxhia në Grottaferrata¹⁵. Artikulli përmban riprodhimin e dorëshkrimit në faksimile të origjinalit, në transliterim me shkronja greke dhe në transkriptim në alfabetin e sotëm, sipas leximit të Nilo

¹² J. Rrota, “Ma të parat kopje të fotografueme të Mesharit të Buzukut ndë Shqipëni”, *Nëndori*, nr. 3, 1955, f. 76-79.

¹³ J. Rrota, “Monumenti mâ i vjetri i Gjuhës Shqype. D. Gjon Buzuku (1555)”, *HD*, VI (1930), nr. 1, f. 33-53, me faksimilen e kolofonit; “Prej librit të Buzukut (1555)”, *VI* (1930), nr. 2, f. 108-114; *VI* (1930), nr. 4, f. 231-238; *VI* (1930), nr. 5, f. 292-300; *VI* (1930), nr. 10, f. 569-576; *VI* (1930), nr. 12, f. 671-680.

¹⁴ “Gjyqi i linguistëve të huejë për rreth librit të Buzukut”, *HD*, VI (1930), nr. 3, f. 143-154.

¹⁵ J. Rrota, “Per rreth botimit të dorëshkrimit shqyp të shekullit XIV”, *HD*, VI (1930), nr. 7-8, f. 402-411.

Borxhias me pak ndryshime dhe komente vetjake, shoqëruar edhe me historikun e zbulimit të dorëshkrimit dhe me disa mendime rreth dialektit dhe vendpërdorimit të tij. Një vit më vonë botohet studimi kushtuar Lekë Matrangës dhe Katekizmit të tij të vitit 1592 në gjuhë shqipe¹⁶. Autori i bën jehonë botimit të dorëshkrimit origjinal të Matrangës nga Marco La Piana në vitin 1912, pas zbulimit të tij në Vatikan, dhe me këtë rast riprodhon krejt tekstin shqip të dorëshkrimit, në transliterim me alfabetin e Matrangës dhe në transkriptim në alfabetin e sotëm, me gjithë “Kângën e Përshpirtshme” që, siç dihet, mungon në tekstin e shtypur.

Kontributi më i rëndësishëm i Justin Rrotës dhe i “Hyllit të Dritës” në filologjinë e teksteve shqipe dhe historinë e shkrimit të shqipes është vepra e tij “Per historin e alfabetit shqyp”, e botuar në 12 numra të revistës, duke filluar nga numri 12 i vitit 1931¹⁷. Në studim analizohen sistemet alfabetike në veprat e 23 autorëve dhe shoqatave apo gazetave, me ilustrime pjesësh të riprodhuara me grafinë origjinale dhe të transkriptuara në alfabetin e sotëm, duke filluar që nga copëzat shkrimore parabuzukiane, autorët e vjetër të shekujve XV-XVII, shkrimet e shek. XVIII, si Kuvendi i Arbënit, F. M. da Lecce, Gjon Kazazi, Jul Variboba, shekulli XIX me Dhiatën e Re toskërisht (1827), autorët arbëreshë De Rada, Santori, Serembe, Kamarda, gazeta Fjala e T’In Zoti e Pal Skiroit, alfabeti i Stambollit me një vjershë nga Naim Frashëri, alfabeti i shkodranishtes së vjetër në botimet e Propagandës dhe më pas të shtypshkronjës Zoja e Papërlyeme në Shkodër e deri te alfabetet e shoqërive Bashkimi e Agimi në shekullin XX, duke përfunduar me alfabetin e Manastirit në 1908. Studimi i Rrotës mbetet kurdoherë themelor për çdo studim të mëvonshëm në këtë fushë.

Me interes për historinë e teksteve të vjetra janë edhe kërkimet e Filip Fishtës në bibliotekat e Romës, të pasqyruara në artikujt e tij “Gjurmimet e një mueji në Romë”¹⁸. Mësojmë ndër të tjera se ai është personi që ka sjellë veprën e Pjetër Budit “Pasëqyra e të Rrëfyemit” të fotografuar nga biblioteka e Vatikanit në Shqipëri. Në atë bibliotekë ai ka gjetur edhe dy kopje të botimit të parë të Kuvendit të Arbënit, nga të cilat jep për herë të parë një përshkrim të hollësishëm, shoqëruar edhe me pjesë të transkriptuara

¹⁶ J. Rrota, “Shkrimtari më i vjetri i Italo-Shqyptarvet, Lukë Matranga (1592)”, *HD*, VII (1931), nr. 8, f. 505-522.

¹⁷ J. Rrota, “Per historin e alfabetit shqyp”, *HD*, VII (1931), nr. 12, f. 676-684; VIII (1932), nr. 3, f. 123-129; VIII (1932), nr. 5, f. 223-230; VIII (1932), nr. 7-8, f. 341-350; IX (1933), nr. 9-10, f. 464-474; IX (1933), nr. 11, f. 514-518; X (1934), nr. 1, f. 15-21; X (1934), nr. 3, f. 140-147; X (1934), nr. 11, f. 529-535; XI (1935), nr. 1, f. 8-19; XII (1936), nr. 2, f. 61-67; XII (1936), nr. 4, f. 171-176.

¹⁸ *HD*, XVI (1940), nr. 10-11, f. 498-515; XVII (1941), nr. 1-2, f. 46-57; 3-5, f. 171-177.

në alfabetin e sotëm. Kërkimet në bibliotekat e Romës kanë sjellë edhe sqarimin përfundimtar të çështjes së pseudobotimeve të veprës së Bogdanit, të Venecies 1691 e 1702, duke pohuar qenien e një botimi të vetëm, atij të Padovës të vitit 1685, të rishitur në Venecie me titull e kushtime të ndryshuara për qëllime tregtare të botuesit.

Në vitet '40 shënohen si ndihmesa filologjike botimi i “Çetës së profetënvet” të Pjetër Bogdanit nga prifti filolog Mark Harapi, dhe i disa fragmenteve nga pjesa e dytë e kësaj vepre mbi jetën e Shën Mërisë nga Ndre Mjeda.

Për botimin e dorëshkrimeve shqipe të shekullit XVIII duhet të përmendim ndihmesën e hulumtuesit të zellshëm Lef Nosi, i cili botoi fragmente nga shkrimet e Teodor Haxhifilipit në revistën letrare “Kopështi Letrar” të Elbasanit, gjatë vitit 1918, ndër të cilat gjenden edhe 6 faqet e para nga Meshja e Shën Gjoni Gojartit¹⁹.

Kërkesa për botimin e teksteve të vjetra shqipe u shtrua përsëri në fillim të viteve '50 nga Selman Riza²⁰, me rastin e një analize që ai i bën veprës së Bogdanit, duke theksuar nevojën e ribotimit të plotë të tij. Po në atë kohë, në vitin 1952, gjatë zhvillimit të sesionit II shkencor të Seksionit të Gjuhës e Letërsisë të Institutit të Shkencave Eqrem Çabej shtron nevojën parësore të njohjes së shkrimeve të vjetra të gjuhës si dhe të materialit dialektor e folklorik si premisë për studimin e thelluar të gjuhës shqipe. Ai kërkon si detyrë të parë botimin e teksteve të vjetra si dhe të materialeve burimore të mbledhura e të pabotuara që gjenden në arkiva. Ai vetë kishte kohë që punonte për studimin mbi gjuhën e Gjon Buzukut, që ishte njëkohësisht edhe një punë përgatitore për realizimin mjeshtëror të botimit kritik të ‘Mesharit’, përfunduar në vitin 1958.

Kjo periudhë e viteve '50 shënon një rigjallërim të punës filologjike të botimit të teksteve të vjetra. Në vitin 1958 filologu shqiptar në Itali Namik Resuli nxjerr botimin e parë të plotë të “Mesharit” të Buzukut²¹, me hyrje, aparat kritik, transkriptim e faksimile të origjinalit, bashkë me një indeks të pjesëve latinisht të tekstit. Të dy studiuesit kishin punuar paralelisht, pa ditur për punën e njëri-tjetrit, secili duke zbatuar marrëveshjen e vitit 1943 mes Institutit të Studimeve Shqiptare të Tiranës dhe Qendrës Studimore për Shqipërinë të Akademisë Italiane për botimin e ‘Mesharit’, të ndërprerë nga

¹⁹ Lef Nosi, “Dhaskal Todhri”, *Kopështi Letrar*, Elbasan, 1918, nr. 1, f. 13-14; nr. 2 f. 13; nr. 3, f. 8; nr. 4, f. 11; nr. 5, f. 2; gjashtë faqet e para nga Meshja e Shën Gjoni Gojartit.

²⁰ S. Riza, *Fillimet e gjuhësisë shqiptare*, Prishtinë, 1952.

²¹ N. Resuli, *Il “messale” di Giovanni Buzuku, Riproduzione e trascrizione*. Città del Vaticano, Biblioteca Apostolica Vaticana, 1958.

shkrija e dy instituteve pas luftës. Botimi i Çabejt për fat të keq doli vetëm dhjetë vjet më vonë, më 1968, për shkak të peripeive të shtypit.

Po në vitet '50 gjuhëtari Kostaq Cipo bëri një transkriptim në alfabetin e sotëm të veprës *Dottrina Christiana* të Pjetër Budit, i cili ruhet në arkivin e Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë në Tiranë. "*Dottrina Christiana*" e Pjetër Budit, ishte ribotuar tri herë të tjera në shekujt e kaluar, ku botimi i fundit nën kujdesin e Kongregacionit të Propagandës së Fesë ka qenë ai i vitit 1868, në 250 vjetorin e botimit të parë të veprës më 1618. Kostaq Cipo, duke ndjekur rregullën e parë të punës filologjike, e bëri transkriptimin në bazë të fotokopjes së origjinalit të vitit 1618, të ruajtur në Bibliotekën Kombëtare në Tiranë. Botimi i vitit 1618 është origjinali i mbikëqyruar nga autori, i cili e kreu përkthimin e veprës gjatë qëndrimit të tij në Romë në vitet 1616-1617 dhe e botoi më 7 janar 1618. Transkriptimi është bërë mbi bazën e një njohjeje të mirë të gjuhës së autorit të tekstit nga Cipoja. Ai na ka lënë një studim të ngjeshur prej 25 faqesh për gjuhën e Budit me titull "Vërejtje fonetike, morfologjike e sintaktike mbi "Doktrinën e Kërshtenë" të Budit, botuar në Buletin i Shkencave Shoqërore, 1952, nr. 1. Ndiheza e Cipos për filologjinë e teksteve shqipe plotësohet me një studim të shkurtër por të thukët mbi një dorëshkrim shqip të gjysmës së parë të shek. XIX, të shkruar në alfabetin e Dhaskal Todrit nga një tregtar elbasanas i quajtur Simon. Studimi është botuar pas vdekjes së tij, në revistën *Studime filologjike* të vitit 1964, nr. 1²².

Osman Myderrizi transkripto veprën tjetër të Budit, *Speculum Confessionis*. Të dyja këto punë të gjuhëtarëve janë të ruajtura si dorëshkrime në Arkivin e Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë, dhe kanë shërbyer për nevojat e studiuesve të gjuhës.

Një kontribut të veçantë për studimin dhe botimin e dorëshkrimeve shqipe elbasanase të shekullit XVIII ka dhënë Dhimitër Shuteriqi, në të njëjtën periudhë kohore, me një seri artikujsh botuar në Buletinin për Shkencat Shoqërore, që nga viti 1949 me studimin për dorëshkrimin anonim të Elbasanit²³ dhe gjatë viteve '50 me disa studime për shkrimet e Dhaskal Todhrit dhe ribotimin e të gjitha pjesëve të Todhrit të botuara më parë dhe botimin e pjesëve të pabotuara të ruajtura në Arkivin e Institutit të Historisë²⁴. Deri në fund të jetës së tij ai iu përkushtua gjurmimit, mbledhjes dhe studimit

²² K. Cipo, "Një sy rreth dorëshkrimit të Simonit", *Studime Filologjike*, nr. 1, 1964, f. 183-188.

²³ Dh. Shuteriqi, Anonimi i Elbasanit. Shkrimi shqip në Elbasan në shekujt XVIII-XIX dhe Dhaskal Todhri, në: Buletin i Institutit të Shkencave, Tiranë 1949, 1, f. 33-54.

²⁴ Dh. Shuteriqi, "Shkrime të Dhaskal Todhrit dhe të pasardhësve të tij elbasanas, shoqëruar me fjalorin e shkrimeve të Todhrit", Buletin i Shkencave Shoqërore, nr. 1, 1951, f. 165-197. Po ai, "Dhaskal Todhri", Buletin i Institutit të Shkencave, nr. 4, 1954.

të shkrimeve shqipe, punë që është përfshirë kryesisht në vëllimet *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 1976 dhe *Tekstet shqipe dhe shkrimi i shqipes në vitet 879-1800*, ASHSH, IGJL, Tiranë, 2005.

Po kështu ka merita në studimin dhe botimin e shkrimeve shqipe I. Zamputi, së pari me një studim rreth alfabetit të dorëshkrimit të Anonimit elbasanas, botuar në Buletin i Institutit të Shkencave 1949²⁵, dhe më pas me botimin e vetë dorëshkrimit në transliterim, transkriptim dhe komente²⁶.

Mbas daljes në dritë të botimit kritik të “Mesharit” në vitin 1968 në Shqipëri pati përsëri një periudhë të gjatë heshtjeje në fushën e botimeve të teksteve të vjetra shqipe, ndërsa vëmendja e studiuesve të gjuhës u përqendrua më tepër në fushën e gjuhësisë historike, të dialektologjisë, të gramatikës, sintaksës, leksikologjisë e leksikografisë.

Edhe në filologjinë botërore nuk kemi ndonjë risi përta i përket botimit të teksteve të vjetra shqipe, deri në mes të viteve '80, kur del i pari botim kritik modern i “Doktrinës” së Budit të vitit 1618 nga albanologu danez Gunnar Svane, me transkriptim në alfabetin e sotëm dhe me konkordancat elektronike, me një parathënie mbi autorin, veprën dhe kriteret e transkriptimit. Në të njëjtën mënyrë ai bëri edhe botimin e dy veprave të tjera të Budit, “Ritualit Roman” dhe “Pasqyrës së të rrëfymit”, përveç disa studimeve me vlerë mbi gjuhën letrare të Budit dhe për çështje të grafisë së tij²⁷. Duhet thënë se këto botime Svane i bëri në konsultim të dendur me gjuhëtarin tonë të ndier prof. Shaban Demirajn, mendimet dhe sugjerimet e të cilit kanë zënë vend në këtë punë të lëndueshme të tij. Në ato vite edhe Rexhep Ismajli botoi poezitë e Budit në Prishtinë (1986), me parathënie dhe komente, me faksimile të origjinalit e transkriptim në alfabetin e sotëm.

Mbas viteve '90 filloi një punë e ngjeshur botuese nga filologët shqiptarë për botimin e teksteve të vjetra. Serinë e botimeve kritike të autorëve të vjetër pasbuzukianë e hapi botimi i veprës së Pjetër Bogdanit (1685) nga A. Omari në vitin 2005. Pas disa ribotimeve të pjesshme me karakter popullor apo ribotimesh të plota anastatike, “Cuneus Prophetarum” pati një botim filologjik i cili shoqërohej me hyrje, faksimile të origjinalit dhe rindërtim të tekstit kritik me shënime. Më pas doli “Doktrina e Kërshten” e Gjon Nikollë Kazazit (1743) nga Bardhyl Demiraj, botim i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të

²⁵ I. Zamputi, Disa shënime rreth alfabetit të dorëshkrimit të Anonimit elbasanas, në: Buletin i Institutit të Shkencave, Tiranë 1949.

²⁶ I. Zamputi, “Dorëshkrimi i anonimit të Elbasanit, Transliterim, transkriptim dhe koment”, Buletin i Institutit të Shkencave, Tiranë, 1951.

²⁷ G. Svane, “Formimi i gjuhës letrare te “Speculum Confessionis” e Budit, *Studime filologjike*, Po ai, “How to read “Speculum Confessionis?”, *Studia Albanica*, nr. 1, 1980, f. 121-179. Gjithashtu me studimin e Budit e të gjuhës së tij janë marrë edhe K. Cipo, M. Domi, S. Riza, I. Zamputi, E. Çabej, K. Ashta etj.

Kosovës, Prishtinë, 2006. Ky është i pari ribotim i kësaj vepre, i pajisur me një studim të gjerë për jetën dhe veprën e Kazazit mbi bazën e të dhënave burimore të nxjerra edhe nga kërkimet vetjake të autorit në arkivat e Propagandës së Fesë dhe të Vatikanit, me një studim për tekstin e veprës dhe grafisë e tij, me dy riprodhime të tekstit: atë fotografik dhe riprodhimin diplomatik të zgjeruar, me botimin kritik të tekstit të shoqëruar me shënime shpjeguese të hollësishme dhe me konkordancat leksikore.

I treti autor i vjetër i shqipes, Frang Bardhi, njohu të parin botim filologjik tekstual të Dictionarium-it të tij vetëm në vitin 2008, përgatitur nga Bardhyl Demiraj, me faksimile të origjinalit, riprodhim diplomatik të zgjeruar dhe botim kritik. Ribotimi i parë i Fjalorit nga Mario Roques në vitin 1932 ishte një riprodhim fotostatik shumë i dobishëm për të bërë të njohur këtë tekst tashmë të rrallë. Hyrja që e shoqëronte ishte një studim i thelluar mbi bazën e materialit jetësor e bibliografik të mbledhur prej tij në arkiva dhe biblioteka. Të dhënat e saj për historinë, sidomos kishtare, gjeografinë, përbërjen etnike dhe fetare të popullsisë së Zadrimës, për familjen e Bardhejve të Zadrimës dhe klerikët e lartë të dalë nga gjiri i saj, për jetën dhe veprën e Frang Bardhit dhe më gjerësisht për Fjalorin e tij latinisht-shqip, me vërejtje për historikun, përmbajtjen, sistemin grafik, nuk janë tejkaluar ende sot, prandaj ajo hyrje figuron në botimin e fundit kritik të Demirajt, në përkthimin e Vili Kamsit.

Nga tekstet e arealit kulturor-fetar të Veriut të shekullit XVIII, krahas studimit me karakter historik-politik-fetar për Vendimet e Kuvendit të Arbënit nga Vincenc Malaj²⁸ dhe studimit gjuhësor të tekstit të Vendimeve nga Rexhep Ismajli²⁹, tashmë kemi edhe botimin kritik të tij nga Bardhyl Demiraj (2012), pajisur me shënime dhe me konkordancat leksikore, si dhe me një CD që përmban tekstet origjinale të katër versioneve të “Kuvendit të Arbënit”: tekstin origjinal latinisht të vitit 1706, botimin e parë të përkthimit shqip (1706), botimin e dytë të përkthimit shqip (1868) dhe versionin e dytë të përkthimit shqip nga Engjëll Radoja (1872). Ndërkohë, në vitin 2009, doli edhe botimi kritik i dorëshkrimit të Fjalorit italisht-shqip të F. M. Da Lecces i vitit 1702 nga Gëzim Gurga, pajisur me një hyrje, tekstin kritik të dorëshkrimit dhe fjalësin shqip. Kjo vepër, që deri në vitin 1988 kur u rizbulua në bibliotekën rajonale të Palermos konsiderohej e humbur, ka rëndësi të madhe për historinë kulturore të shkrimit të shqipes dhe për leksikografinë historike të shqipes. Botimit kritik të G. Gurgës i paraprinë dy

²⁸ Vincenc Malaj, *Kuvendi i Arbënit*, Rilindja, Prishtinë, 1998.

²⁹ R. Ismajli, *Gjuha shqipe e “Kuvendit të Arbënit”*, Rilindja, Prishtinë, 1985.

studime nga Matteo Mandalà “Huazimet turke në fjalorin e Da Lecce-s”³⁰ dhe “Fjalori italisht-shqip (1702) i Francesco Maria da Lecce-s”³¹.

Një zbulim i kohëve të fundit që pasuron dijen shkencore rreth teksteve tona të vjetra ishte ai i Blerina Sutës i një ekzemplari të veprës së Pjetër Budit “Dottrina Christiana” e vitit 1618, pra i botimit të parë të saj, në një bibliotekë të Romës, i cili ndryshonte me një fashikull më tepër në krahasim me ekzemplarën e njohur të veprës së Budit që ruhet në Bibliotekën Apostolike të Vatikanit (BAV), dhe që rezultoi se ka qenë në dorën e vetë autorit. Studiuesja, krahas përshkrimit krahasues të ekzemplarëve, rindërtimit të rrethanave të zëvendësimit nga ana e Budit të fashikullit të parë të veprës që ai i dorëzoi BAV-it, studimit të ndikimeve të kontekstit ballkanik në letërsinë e vjetër shqipe, sjell edhe tekstin e fashikullit A të gjetur në bibliotekën Angelica, të transkriptuar në alfabetin e sotëm³².

Teksti më i vjetër i arealit jugor, katekizmi i Lekë Matrëngës, njohu një edicion të ri kritik bashkëkohor në vitin 2004 nga studiuesi arbëresh Matteo Mandalà, të pajisur me një studim monografik, me faksimile të origjinalit e transkriptim të të tria dorëshkrimeve të veprës dhe të librit.

Pas botimit të parë të “E mbsuame e krështerë” nga Marco La Piana në vitin 1912, prifti filolog arbëresh Matteo Sciambra bëri një botim të dytë kritik, me riprodhim anastatik, transkriptim e komente në vitin 1964. Botimi i tretë i veprës u bë nga studiuesi Fadil Sulejmani në vitin 1979, i cili botoi një monografi për jetën, veprën dhe gjuhën e Matrëngës dhe transkriptoi dsh. I dhe librin e shtypur, të gjetur si fotokopje në Bibliotekën kombëtare në Tiranë. Ndërkohë me Matrëngën dhe katekizmin e tij u morën edhe studiues me peshë si M. Roques (RT 19), i cili bëri një përshkrim të të tri dsh., S. Riza, i cili i kushtoi një kapitull në monografinë për pesë autorët e vjetër të shqipes dhe bëri përshkrimin krahasues të tri dsh., pastaj edhe K. Ashta, Dh. Shuteriqi etj.

Megjithatë procesi i ndërlikuar editorial që kaloi vepra e Matrëngës dhe zbrazëtitë në dokumentacionin e lidhur me të bëri që objektivisht shumë çështje të rëndësishme të historisë së tekstit të veprës, të grafisë e të gjuhës së saj të mbeteshin pa një zgjidhje të argumentuar. Puna e Mandalait mbështetet në të dhëna burimore të reja të zbuluara mbas hulumtimesh afatgjata afro

³⁰ M. Mandalà, “Il Dittionario del Da Lecce e i turchismi in albanese (sec. XVII-XVIII)”, në *Albanica* 10, Quaderni di Lingua e Letteratura Albanese, Palermo, 1995.

³¹ M. Mandalà, “L’opera inedita di Francesco Maria Da Lecce: Il *Dittionario italo-albanese (1702)*”, në *Atti del 2 Seminario Internazionale di Studi Albanesi*, a cura di Francesco Altamari, *Quaderni del Dipartimento di Linguistica*, 14, Albanistica, Rende, 1997.

³² Blerina Suta, *Faqe të panjohura nga vepra e Pjetër Budit (1618-1622)*, Onufri, Tiranë, 2016.

njëzetvjeçare, të cilat, kombinuar me vlerësimin kritik të traditës studimore paraardhëse e me një vështrim të mprehtë e të thelluar filologjik të teksteve, kanë sjellë saktësimin e mjaft problemeve të keqinterpretuara, zgjidhjen e disa çështjeve të mbetura pezull apo edhe zgjidhje të reja të disa të tjerave, duke iu afruar mundësisht sa më pranë të vërtetës ekdotike të veprës.

Filologjia e teksteve të shkrimtarëve arbëreshë pati një rigjallërim që nga vitet '60-'70 me punët e Matteo Sciambres, Gradilonos, Solanos e më pas në vitet '80 me botimet e Fortinos e Altimarit. Tradita e pasur filologjike arbëreshe, me zhvillimin që ka përjetuar sidomos dy dhjetëvjeçarët e fundit, me punën intensive për botimin e teksteve arbëreshe me metoda e teknika të përparuara, i ka dhënë nxitje dhe mbështetje edhe filologjisë tekstuale në Shqipëri.

Në këtë hulli shkon tani së fundi puna për botimin kritik të veprave të Françesk Anton Santorit, pjesa më e madhe e të cilave gjendet në dorëshkrim, e pabotuar, e ndërmarrë nga kolegja e Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë Merita Bruci, nga të cilat është botuar në Napoli pjesa e parë e romanit Sofia Kominiate, ndërsa është në proces botimi drama e parë në gjuhën shqipe, "Emira", në një botim kritik të plotë bashkë me variantet e krahasuara.

Peshën kryesore në shkrimet e vjetra shqipe e zënë tekstet e shtypura. **Dorëshkrimet** janë shumë të rralla dhe fragmentare. Megjithatë këto "grimca", kryesisht parabuzukiane, për rëndësinë madhore që kanë si fillimet e shkrimit të shqipes kanë njohur botime e interpretime të shumta nga albanologët, duke filluar që nga zbuluesit e tyre. "Formula e Pagëzimit" u botua së pari nga zbuluesi i saj, historiani i shquar rumun Nicola Jorga, në veprën e tij "Notes et extraits pour servir à l'histoire des Croisades au XV siècle", më 1915. Përveç Jorgës, Formula u botua nga shumë studiues të tjerë, si M. Roques (*Romania* LII (1926), F. Ribezzo Riv. *Indo-Greco-Italica* XVI (1932), J. Rrota (*Për historin e alfabetit shqyp*, Shkodër, 1936) e në antologjinë *Shkrimtarët shqiptarë* I, 1941, M. La Piana, *Studi linguistici albanesi*, Palermo, 1949 dhe Namik Ressuli, në *Shpirti shqiptar* 1954-'55 e më vonë në librin *I più antichi testi albanesi*, 1978, me një studim kritik. Perikopeja e Ungjillit të Pashkëve, u botua së pari nga zbuluesi i saj Spiro Lambros në revistën "Neos Elinomnimon" III 1906. Ajo u ribotua më vonë, në vitin 1930 nga Nilo Borgia nga Grottaferrata në riprodhim fototipik, me transkriptim e komente³³, po atë vit nga Justin Rrota në Hyllin e Dritës 1930, nr. 7-8, pastaj nga F. Ribezzo në transkriptim në alfabetin latin me shënime kritike në revistën *Indo-Greco-Italica* 1932, e më vonë nga N. Ressuli në

³³ N. Borgia, *Pericope evangelica in lingua albanese del sec. XIV*, Grottaferrata, 1930.

Shpirti shqiptar 1954-'55 e pastaj në librin *I più antichi testi albanesi* 1978; nga Selman Riza në *Fillimet e gjuhësisë shqiptare* 1952 etj.

Fjalorthi i A. von Harffit i vitit 1497 u botua për herë të parë nga Everhard von Groote, Cöln, 1860. I pari që dha përkthimin shqip të përshkrimeve të udhëtimit nga Shqipëria ishte Lumo Skëndo në revistën *Diturija* II (1927). Botime të tjera të listës me fjalë e shprehje shqipe, të mbështetura në botimin e von Grootes, janë bërë nga Ch. Hopfi, G. Meyeri, M. Roques, F. Konica, G. Petrotta; një studim më të gjerë me komente i ka kushtuar Namik Ressuli (*I più antichi testi albanesi*, 1978), e tani së fundi e ka ribotuar edhe Robert Elsie, i cili ka dhënë edhe përkthimin në anglisht. Është botuar në R. Elsie: *Early Albania, a Reader of Historical Texts, 11th - 17th Centuries*, Wiesbaden 2003, f. 31-33.

Vlen të përmendet studimi i kohëve të fundit i fjalorthit të Arnold von Harffit nga Kelly Lynne Maynard e Universitetit të Çikagos, me interpretime të reja për leximin e glosave dhe shprehjeve shqipe.³⁴

“Grimcave” parabuzukiane u duhet shtuar edhe e ashtuquajtura “formulë e mallkimit” shqip në një komedi të vitit 1483 të një autori venecian, Tommaso de Mezzo, me titull “Epiroti”. Dokumenti u botua nga zbuluesi i tij Ludwig Braun së bashku me interpretuesin e tij Martin Camaj në *Zeitschrift für vergleichende Sprachforschung* 1972/1. E ribotoi Camaj, me titull “Una frase in albanese”, me faksimile dhe më pas e rilexoi Dh. Shuteriqi në “Tekstet shqipe dhe shkrimi i shqipes...”. Kohët e fundit Bardhyl Demiraj e ka rimarrë formulën në një studim të plotë gjuhësor-filologjik duke vënë në dukje vështirësitë e interpretimeve të deritanishme dhe duke dhënë edhe një interpretim të ri³⁵.

Me punën intensive të kohëve të fundit nga albanologët brenda dhe jashtë vendit mund të themi se filologjia e teksteve të vjetra shqipe ka përmbushur detyrat themelore të saj duke nxjerrë në dritë botimet kritike të autorëve kryesorë të shqipes së vjetër. Tashmë gjithë kjo veprimtari botuese mbetet të japë frytet e saj në hartimin e një Thesaurusi të shqipes së shkruar të shekujve XVI-XVIII.

Mbetet gjithmonë i hapur kërkimi i mëtejshëm në gjurmë të dorëshkrimeve ende të panjohura dhe botimi shkencor i atyre që njihen. Në këtë rrugë mund të përmendim botimin e letrës shqip të Gashit (1689) nga M. Camaj e P. Bartl³⁶ më 1967, botimin kritik të letrës së fretënve të Pultit (1761)

³⁴ K. L. Maynard, “‘I want to buy it’ in the albanian Glossary of Arnold von Harff”, *Transactions of the Philological Society*, vol. 107: 2 (2009), f. 231-252.

³⁵ B. Demiraj, “Mallkimi i epirotit (1483)”, *Hylli i Dritës*, nr. 1, 2012.

³⁶ Peter Bartl & Martin Camaj, “Ein Brief in albanischer Sprache aus Gashi vom Jahre 1689”, në: *Zeitschrift für Balkanologie*, nr. 5, 1967, f. 23-33.

nga B. Demiraj me P. Bartl³⁷, botimi kritik i teksteve të shkurtra shqip të Zef Skiroit (ndoshta 1746) nga B. Demiraj³⁸ apo letrat e tregtarëve shkodranë nga Kolë Ashta³⁹.

Filologjia tekstuale shqipe i mbetet ende një borxh të madh letërsisë shqipe në alfabetin arab dhe asaj në alfabetin grek. Duhet përmendur këtu ndihmesa e rëndësishme e Osman Myderrizit, me një numër studimesh për letërsinë me alfabet arab, si: “Letërsia shqipe me alfabet arab”, Buletini për shkencat shoqërore 2, Tiranë, 1955, f. 187-291; “Dorëshkrime të panjohura të Gjirokastrës”, Buletini për shkencat shoqërore 2, Tiranë 1959; “Tekste të vjetra shqipe me alfabet arab”, Konferenca e parë e studimeve albanologjike, Tiranë, 1965, po edhe transliterime të tjera dorëshkrimesh të depozituara në Arkivin e Institutit të Gjuhësisë; I. Zamputi, “Një dorëshkrim bektashian gjysmës së shekullit XIX (1850-1860)”, Buletin për shkencat shoqërore nr. 4, Tiranë, f. 64-131. Idriz Ajeti ka dhënë kontribut në njohjen dhe studimin gjuhësor të veprës së dy autorëve që kanë shkruar shqip me alfabet arab: Tahir Efendi Boshnjakut nga Gjakova dhe të Sheh Hilmi Maliqit nga Rahoveci. Mund të përmenden edhe studiues të tjerë nga Kosova që kanë dhënë kontribut për njohjen dhe vlerësimin e kësaj letërsie, si Hasan Kaleshi, Mahmud Hysa, Muhamet Pirraku, Abdulla Hamiti (“Nezim Frakulla dhe Divani i tij shqip”, Logos-A, 2008) etj. Për sa u përket botimeve kritike të kësaj letërsie, vitet e fundit ka punuar në këtë fushë Genciana Abazi-Egro, duke përgatitur në botim kritik tekstual Divanin e Nezim Frakullës (Beratit) (QSA, Tiranë, 2009) dhe poezitë e Hasan Zyko Kamberit (QSA, në shtyp)⁴⁰. Rëndësia e dorëshkrimeve shqipe me alfabet arab duhet theksuar pasi kjo letërsi është vijuese e drejtpërdrejtë në kohë e letërsisë së vjetër të Veriut, madje edhe bashkëkohëse me të. Kështu p.sh. poezia e Muçi Zades (1725) shkruar me alfabetin arab, e gjetur në Korçë, një lutje humoristike kushtuar kafesë që autori i drejton Perëndisë, është pas gjase e vitit 1714, dhe në këtë

³⁷ B. Demiraj & Peter Bartl: La lettera dei frati di Pulati (1761), il suo sfondo storico ed il suo posto nella cultura della scrittura albanese, në: “Nordalbanien – L’Albania del Nord. Linguistisch-kulturhistorische Erkundungen in einem unbekanntem Teil Europas” (Hrsg. Monica GENESIN & Joachim MATZINGER) Hamburg 2009, f. 63-79.

³⁸ Shih B. Demiraj, *Zef Skiroi në kulturën e shkrimit shqip të shek. XVIII*, në: “Studime” 12 [2005] 67 – 97, Prishtinë 2006.

³⁹ K. Luka, *Letërkëmbimi i firmës tregtare Bianku-Çoba, 1877-1878*, përgatitur nga K. Luka, Ombra GVG, 2000.

⁴⁰ Kjo autore jep edhe të dhëna për botimin e trashëgimisë letrare me alfabet arab nga nacionalistët shqiptarë në periudhën e Rilindjes, shih: G. Abazi-Egro, “Trashëgimia letrare dhe procesi i kombformimit modern tek shqiptarët”, Studime filologjike, nr. 3-4, 2015, f. 173-188, në shtyp.

mënyrë dokumenti i parë në toskërishten e trojeve kompakte shqiptare. Një panoramë të shkrimeve të shqipes me alfabetin arab dhe me atë grek na jep Robert Elsie në dy kontribute të tij të rëndësishme⁴¹, ndërsa veprat e Shuteriqit na njohin edhe me gjendjen e botimeve tekstuale në këtë fushë.

Vitet e fundit janë bërë përpjekje të rëndësishme në fushën e botimit të teksteve shqipe në alfabetin grek. Xhevat Lloshi botoi Ungjillin sipas Mateut nga Dhiata e re në gjuhën shqipe përkthyer nga Vangjel Meksi, në dy variante: dorëshkrimi i Vangjel Meksit i vitit 1824 dhe botimi i vitit 1827, redaktuar nga Grigor Gjirokastriti. Vepra përfshin një studim të gjerë hyrës për rrethanat historike e kulturore të përkthimit të Dhiatës së re në shqip dhe punën e bërë nga autori i përkthimit dhe redaktori i tij, si dhe studimin krahasues stilistik e gjuhësor të dy varianteve⁴².

Kontributi i pasur dhe ende i pabotuar i Thimi Mitkos po sheh dritën e botimit përmes përkushtimit të filologëve e koleksionistëve të pasionuar. Koleksionisti Shpëtim Sala ra në gjurmë dhe bleu dorëshkrimin e një fjalori trigjuhësh të Mitkos, italisht-greqisht-shqip dhe e botoi në dy variante: fototipi të originalit dhe transliterim në alfabetin e sotëm, me fjalësin shqip dhe studim hyrës mbi jetën dhe veprën e autorit⁴³.

Dhori Qiriazi, me një punë të kujdesshme filologjike, botoi dy dorëshkrime fjalorësh të Thimi Mitkos: fjalorin shqip-greqisht dhe fjalorin greqisht-shqip, me një tregues të fjalësit shqip dhe një CD me fotot e dorëshkrimeve autografe të Mitkos. Botimit i paraprin një studim i rëndësishëm për veprën leksikografike të Thimi Mitkos, punën e tij me gjuhën letrare të kohës, momentet kryesore të jetës së tij dhe kriteret e botimit në alfabetin e sotëm shqip⁴⁴.

Zbatimi i metodave filologjike shkencore në botimet kritike të teksteve shqipe

Botimi i librit të parë shqip, “Mesharit” të Gjon Buzukut, nga korifeu i albanologjisë shqiptare Eqrem Çabej, shënoi një hop cilësor në fushën e

⁴¹ R. Elsie, “Albanian literature in the Moslem tradition. Eighteenth- and early nineteenth century Albanian writing in Arabic Script, në: *Oriens. Journal of the International Society for Oriental Research*, Leiden, 1992, nr. 33, f. 287-306; Po ai, “Albanian alphabet in Greek Script. The eighteenth- and early nineteenth century Orthodox tradition writing”, në *Byzantine and modern Greek Studies*, Birmingham, nr. 15, 1991, f. 20-34.

⁴² Xh. Lloshi, *Përkthimi i V. Meksit dhe redaktimi i G. Gjirokastritit 1819-1827*, Onufri, Tiranë, 2012.

⁴³ Sh. Sala, *Fjalori italisht-greqisht-shqip i Thimi Mitkos*, I Dorëshkrimi origjinal, II Transliterimi dhe fjalësi shqip, Westprint, Tiranë, 2013.

⁴⁴ Dh. Qiriazi, Thimi Mitko, *Fjalëtore shqip-gërqisht gërqisht-shqip dhe ndihmesa të tjera leksikografike*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2014.

filologjisë së teksteve të vjetra shqipe me zbatimin e një metode shkencore në përpunimin filologjik të një teksti shqip të shekullit XVI. Nga përvoja e fituar në punën me “Mesharin” e Buzukut ai përvijoi një model ekdotik të vlefshëm për filologjinë shqipe në përgjithësi, në një artikull të ngjeshur programatik për brezat e filologëve shqiptarë⁴⁵. Çabej solli disa risi të rëndësishme në fushën e filologjisë tekstuale shqipe. *Së pari*, ai shtroi si kërkesë dhe zbatoi në praktikë domosdoshmërinë e punës që i paraprin një botimi tekstologjik, ku hyjnë: kërkime sistematike lidhur me atë që quhet “historia e tekstit”, studimi i rrethanave shoqërore-kulturore e politike-fetare të hartimit të veprës në shqyrtim si premisa për qëllimin e shtypjes së saj, hetimi i personalitetit të autorit të veprës e i formimit të tij kulturor si elemente të rëndësishme për të shpjeguar karakterin e veprës dhe tiparet e saj. *Së dyti*, ai bëri dallimin parimor midis riprodhimit diplomatik të tekstit dhe botimit kritik, dhe këtë parim e ndoqi me konsekuencë gjatë gjithë punimit⁴⁶. Botimi i parë i plotë i Namik Resselit në vitin 1958, me dy parimet e tij, më një anë riprodhimin besnik të *gjuhës* së Buzukut me anë të alfabetit të sotëm shqip, e më anë tjetër ruajtjen e veçorive karakteristike të *sistemit grafik* të Buzukut, në vetvete përbënte një kompromis mes riprodhimit diplomatik e botimit kritik. *Së treti*, Çabej në botimin kritik të “Mesharit” ose transkribimin fonetik ndoqi parimin filologjik shkencor të rindërtimit të një teksti që pasqyronte gjuhën e autorit, mundësisht siç e kishte folur ai ose bashkëkohësit e tij në shekullin XVI, duke u mbështetur për këtë në të folmet e sotme të krahinave veriore, në tekstet e tjera të vjetra geqe, në të dhënat e historisë së gjuhës shqipe e në veçoritë e vetë gjuhës së Buzukut në bazë të të dhënave që jep teksti i tij.

Modeli ekdotik i Çabejt tashmë ka krijuar një shkollë në fushën e botimeve kritike të teksteve të vjetra shqipe.

Disa veçori të përgjithshme që karakterizojnë këto botime kritike dhe u japin një vulë shkencore bashkëkohore janë, së pari, puna kërkimore paraprake e pasqyruar në studime hyrëse ku përshkruhen aspektet e jetës, personalitetit, formimit dhe rrethanave historike-kulturore të veprimtarisë së autorit e të hartimit të veprës së tij, të domosdoshme për vetë të kuptuarit e tekstit dhe interpretimin filologjik të tij. Së dyti, parashtrimi i metodave ekdotike dhe kritereve të zbatuara për botimin kritik. Bie në sy që këto kritere janë të argumentuara gjuhësisht me mbështetjen e të dhënave që ofrojnë dialektet e sotme të shqipes, të projektuara historikisht në fazën e zhvillimit

⁴⁵ E. Çabej, “Tekstet e vjetra shqipe dhe disa kritere rreth botimit të tyre”, BUSHT SSHSH, nr. 2, 1959, ribotuar në: *Studime Gjuhësore VI*, Prishtinë, 1977, f. 329-339.

⁴⁶ Një metodë të tillë me tre riprodhime të tekstit, fotostatik, diplomatik e interpretues, e zbatuan së pari Schirò – Petrotta, me sugjerimin e Francesco Ribezos, në botimin e pjesëve biblike nga “Meshari” në revistën *Indo-Greco-Italica* në vitet 1932-33.

gjuhësor që përfaqëson gjuha e tekstit, me mbështetje në krahasimet me autorët e tjerë pak a shumë bashkëkohës të të njëjtit areal gjeografik, e në të dhënat gjuhësore e statistikore që jep vetë teksti origjinal. Nëpërmjet kësaj procedure botimet e sotme kritike të teksteve të vjetra shqipe synojnë të rindërtojnë një tekst sa më pranë atij që ka dashur vërtet të shprehë autori i tij, duke iu afruar gjuhës së autorit me karakteristikat e tij individuale apo, më gjerë, të bashkëkohësve të tij.

Së treti, botimet e sotme kritike sjellin risi në zgjedhjet konkrete grafike të problemeve grafike-ortografike që paraqesin tekstet e vjetra shqipe. Në bazë të karakteristikave të ngjashme që kanë tekstet e arealit kulturor-fetar të Veriut, botimet kritike të tyre natyrisht përmbajnë zgjidhje të njëjta ose të përafërta të mjaft problemeve që paraqet grafia e tyre. Disa nga kriteret gjuhësore e konvencionet grafike të përdorura nga Çabej në zgjidhjen e çështjeve të vështira të grafisë së Buzukut janë të vlefshme edhe për autorët e tjerë të të njëjtit areal verior.

Në botimin e tij kritik të teksteve të Budit Gunnar Svane u mbështet në përgjithësi në parimet e Çabejt, por në disa raste edhe u largua prej tij në zgjidhje të veçanta të problemeve të ndryshme që shtronte teksti i Budit, duke vepruar në përshtatje me veçoritë gjuhësore dhe drejtshkrimore të tij. Pa mundur të pohojmë me siguri nëse Pjetër Budi e ka njohur librin e paraardhësit të tij, mund të themi se ai çeli rrugën e një tradite të ndryshme grafike-ortografike nga ajo e Buzukut, me ndikime tashmë nga italishtja që rrezatonte Roma si qendër botimi e veprave të sponsorizuara nga Kongregacioni i Propagandës së Fesë. Në krahasim me autorin e parë të shqipes, Budi përdor një fjalor shumë më të pasur e një stil më të stërholluar. Edhe në çështje të grafisë ai bëri përparime në drejtim të thjeshtimit të polisemisë së shkronjave që karakterizonte Buzukun. Përkundrazi, në çështje të drejtshkrimit, e sidomos në ndarjen e fjalëve, Budi bën një hap mbrapa dhe të jep përshtypjen e një fillestari. Ndërsa Buzuku përdor një drejtshkrim të mbështetur në shqiptimin e spikatur⁴⁷, Budi pasqyron në shkrim shqiptimin e lidhur karakteristik të gjuhës së folur. Si rrjedhim, në qoftë se në botimin kritik të veprës së Buzukut problem kryesor ishte interpretimi i grafive shumëvlerëshe, në botimin kritik të Budit vështirësia kryesore qëndron në segmentimin e fjalëve. Svane në botimin e tij ka ndjekur një rrugë të matur e të studiuar mes kërkesave themelore të drejtshkrimit modern që kufijtë e fjalës duhen shënuar me një hapësirë dhe synimit për të ruajtur mënyrën e shqiptimit të autorit. Për të ndarë grafitë që përfaqësojnë bashkëtingëllore të asimiluara në kufi të fjalëve, ai përdori një konvencion grafik, shenjë e

⁴⁷ S. Riza, "Fillimet e gjuhësisë shqiptare", në: *Vepra 1*, ASHAK, Prishtinë, 1996, f. 265.

tildes, për të vënë në dukje dukurinë e asimilimit, pa ndërhyrë për të rindërtuar format e drejta që qëndrojnë prapa këtyre grafive⁴⁸.

Kodi grafik dhe drejtshkrimi i Budit, të njohur nëpërmjet përhapjes së gjerë të librave të përkthyer prej tij, krijuan një traditë në shkrimet shqipe të shekujve XVII-XVIII. Bashkë me anët pozitive, Bardhi e Bogdani imituan deri në njëfarë mase edhe modelin e tij drejtshkrimor me grafi të bashkuara. Zgjedhja ekdotike e Svanes shërbeu si model në botimet e mëpasme kritike të autorëve të vjetër të shqipes. Në botimin kritik të “Cuneus Prophetarum” të Bogdanit ne kemi përdorur konvencionin grafik të shpikur nga Svane për të zgjidhur problemin ekdotik të ndarjes së grafive të bashkuara të lokativave të tipit *ndë maltë Sinait* ose të sintagmave emërore të tipit *vepëratë mira*, veçori tipike të drejtshkrimit bogdanian. I njëjti konvencion është përdorur edhe në botimet kritike të përgatitura nga Bardhyl Demiraj për veprën e Gjon Nikollë Kazazit “Doktrina e Kërshten” dhe për Fjalorin latinisht-shqip të Frang Bardhit. Në këtë mënyrë mund të themi se tradita e përbashkët grafike-ortografike e autorëve të shekujve XVII-XVIII kushtëzoi edhe disa zgjedhje të ngjashme të botimeve kritike të veprave të tyre.

Nga ana tjetër veçoritë specifike të *usus*-it shkrimor të autorëve të veçantë kanë ndikuar në zgjedhje të ndryshme ekdotike të botuesve kritikë. Një konvencion grafik që ka formuar traditë në botimet filologjike të autorëve të vjetër që nga Çabej e këtej është riprodhimi i zanoreve të gjata të shqipes veriore me një vizë sipër grafemës së zanores përkatëse, siç përdorej në traditën e studimeve albanologjike. Një shmangie nga kjo mënyrë paraqitjeje bëri Svane për grafemat e dyfishuara të Budit, duke e ruajtur geminacionin edhe në botimin kritik. Kjo nënkupton një shqiptim jo me zanore të gjata, por me dyfishim të tyre. Argumentin për këtë zgjedhje botuesit ia dha analiza e metrikës së poezive të Budit, në të cilat vihet re se, kur në vargjet e tij tetërrokëshe haset një zanore dyfishë, poeti e llogarit atë si dy masa gjatësie, pra si dy rrokje. Kështu botuesi kritik u përpoq t’i afrohet mënyrës si e kuptonte autori natyrën e zanoreve të gjata, në respekt të vullnetit të këtij. Kjo gjetje e tij nuk u rimor në botimet e shkrimtarëve pasardhës, pasi tekstet e tyre nuk jepnin shkas për një interpretim të tillë.

Analiza grafike e gjuhësore e tekstit të Gjon Kazazit ndikoi në një zgjedhje të veçantë ekdotike të botuesit kritik të tij Bardhyl Demiraj. Siç dihet Kazazi e dalloj në shkrim tingullin e mesëm [ə] të shqipes me anë të dy grafemave të posaçme, variante të njëra-tjetrës, ⟨æ⟩ dhe ⟨ę⟩, por këtë nuk e bëri konsekuentisht dhe shumë shpesh i alternoi këto grafema me shkronjën ⟨e⟩. Ky fakt i përdorimit të ⟨e⟩-së si variant grafik i shva-së, analiza e rregullave grafike të Kazazit, ku variantet ⟨æ⟩ dhe ⟨ę⟩ në kombinimet e tyre

⁴⁸ G. Svane, “How to read “Speculum Confessionis?”, *art. i cit.*, f. 152.

me grafema të tjera u nënshtrohen të njëjtave rregulla përfaqësimi si ato të zanores së përparme [e], tiparet dialektore të së folmes amtare të autorit dhe më gjerë të arealit gjuhësor të gegërishtes veriore, ku në gjendjen e sotme zanorja qendrore [ə], në ato pozicione ku ekziston, realizohet me një hapje drejt [e]-së, e kanë shtyrë botuesin kritik të përsiasë për kohën kur shkroi Kazazi një gjendje nyjëtimore të kësaj zanoreje qendrore në zhvillim e sipër drejt hapjes në [e]. Këtë fazë zhvillimi të [ə]-së ai e pasqyroi në botimin kritik të “Doktrinës” së Kazazit me një shenjë të posaçme «è», jashtë kodit alfabetik të shqipes standarde.

Një problem që ndoshta vlen të shtrohet për diskutim është interpretimi në disa raste të veçanta i shenjës «λ» si përfaqësuese grafike e likuidës velare [l] te Bogdani dhe në shkrimet e vjetra pas tij, si Kuvendi i Arbënit dhe Fjalori italisht-shqip i Da Lecces. Bogdani që i pari që vuri në përdorim këtë risi grafike në kodin e tij alfabetik, duke e përcaktuar qartë vlerën e saj: “λ greke në vend të ll dyfishe, si *λυλα e kaeanit* ‘tromba del lambiccò’”. Ai e përdori përgjithësisht me konsekuencë këtë rregull shkrimor në tekstin e tij, por nuk janë të pakta rastet e ngatërrimit të grafemave të të dy likuidave njëra për tjetrën. Sidomos të habit shkrimi i «λ» në leksema që në mbarë shqipen shqiptohen me likuide palatale: *mbëshel*: «*mbescele*», *ngul*: «*ngulè*», *fal*: «*fale*», *çel*: «*celè*», *lule*: «*lule*», *malësor*: «*Mallessoret*», *xhelat*: «*gieletet*», *djalë*: «*Djalè*», *kalë*: «*kalinë*», *polem*: «*Polemi*», *seli*: «*Selia*» etj. Në rastin e një libri të shtypur, siç është vepra e Bogdanit, kjo anomali mund të shpjegohet me një lapsus të autorit, i cili mund të ketë përdorur gabimisht geminacionin thjesht grafik të «l»-së për shprehje a për analogji me geminacionin e italishtes, të cilin radhitësit do ta kenë këmbyer mekanikisht me *lambdën* greke, duke ditur që kjo përdoret për «ll» dyfishe. Po si mund të shpjegohet shkrimi i kësaj shenje në një dorëshkrim, siç është ai i Fjalorit të Da Lecces, pikërisht në disa nga leksemat që përmendëm. Për mendimin tim kjo mund t’i vishet ndjenjës së pasigurisë të këtij autori të huaj në dallimin e dy llojeve të likuidave në shqipe dhe në përfaqësimin grafik respektiv të tyre, veçanërisht në rastet e likuidave ndërzanore.

Një tipar tjetër i përbashkët i botimeve të sotme filologjike të teksteve të vjetra shqipe, që u jep atyre karakter shkencor, është dokumentimi në aparatit kritik i ndërhyrjeve të veçanta rregulluese të botuesve kritikë ndaj tekstit origjinal, si dhe shënimet shpjeguese me natyrë filologjike rreth gjuhës së tekstit e grafisë së tij.

Një prirje bashkëkohore në botimet e teksteve të vjetra shqipe është zbatimi i teknikave të reja kompjuterike në përpunimin e tyre. I pari që zbatoi një teknikë të tillë të përparuar që në vitet 1985-’86 ishte G. Svane, i cili botimin e veprave të Budit e shoqëroi me konkordancat elektronike në 12 vëllime të krejt teksteve të tyre. Megjithëse konkordancat nuk paraqiten në

formë të lematizuar, por si një renditje e thjeshtë alfabetike e të gjitha fjalëformave të tekstit me një kontekst të caktuar dhe vendndodhjen përkatëse, ato përbëjnë një kontribut të vlefshëm në rrugën drejt përpilimit të një fjalori historik të shqipes së vjetër.

Bardhyl Demiraj gjithashtu i ka pajisur botimet e tij kritike me konkordancat elektronike përkatëse. Teksti shqip i Dictionarium-it të Frang Bardhit paraqitet në formën e konkordancës leksikore të lematizuar, që praktikisht na jep kahun e kundërt të fjalorit latinisht-shqip të Bardhit, gjë që përbën një ndihmesë të çmuar për leksikografinë shqipe. Teksti i “Doktrinës” së Kazazit paraqitet po ashtu i konkorduar dhe i lematizuar.

Mbas përpunimit dhe lematizimit të konkordancave të tekstit të Bogdanit ka përfunduar edhe hartimi i një fjalori shpjegues të veprës së Bogdanit si një ekstrakt i konkordancës dhe shoqërues i saj, tashmë në proces shtypi.

Tërësia e konkordancave elektronike të teksteve të vjetra shqipe do të plotësojë lëndën e nevojshme për një Fjalor historik të shqipes së shekujve XVI-XVIII. Një fjalor i tillë i përpunuar me mjete të përparuara bashkëkohore do të përsosë në drejtim të saktësisë shkencore themelin e hedhur me metoda tradicionale nga filologu i palodhur e skrupuloz Kolë Ashta me punën madhore të tij për leksikon e autorëve të vjetër.

Dixhitalizimi i teksteve të vjetra dhe vendosja e tyre në internet, si teksti i Buzukut nga W. Hock dhe tekstet e Matrëngës, Budit, Bardhit, Bogdanit nga M. de Vaan u vë në dispozicion studiuesve material të çmuar për studime të mëtejshme për shqipen e shekujve XVI-XVII.

BIBLIOGRAFI

- Abazi-Egro, G., “Trashëgimia letrare dhe procesi i kombformimit modern tek shqiptarët”, Studime filologjike, 2015/3-4, f. 173-188.
- Ashta, K., *Leksiku historik i gjuhës shqipe* I, Shkodër, 1996, 2000; II, Tiranë, 1998; III, Shkodër, 2000; IV, Shkodër, 2002.
- Bartl, P. & Camaj, M., “Ein Brief in albanischer Sprache aus Gashi vom Jahre 1689”, në: *Zeitschrift für Balkanologie*, nr. 5, 1967, f. 23-33.
- “Bibliografi. Libri i Dom Gjon Buzukut, i shtypun në vjetë 1555”, HD, II (1921), nr. VII.
- Bogdani: Cuneus Prophetarum*. Part 1: Vetus Testamentum. Part II: Novum Testamentum. [Data entered by Michiel de Vaan, 2003, on the basis of the edition by Giuseppe Valentini and Martin Camaj, München

- 1977 (= Beiträge zur Kenntnis Südosteuropas und des Nahen Orients, Band 24].
- Borgia, N., *Pericope evangelica in lingua albanese* del sec. XIV, Grottaferrata 1930.
- Bruçi, M., “Botimet kritike në Shqipëri – misioni i papërbushur i filologjisë shqipe”, në: *Studi sull’Europa Orientale*, a cura di I.C. Fortino – E. Çali, Napoli, 2007, f. 403-416.
- Budi, P., *Poezi*, përgatitur nga R. Ismajli, Rilindja, Prishtinë, 1986.
- Buzuku Missale*. On the basis of the facsimile editions by Namik Ressuli, Il “Messale” di Giovanni Buzuku, Città del Vaticano: Biblioteca Apostolica Vaticana, 1958 and Eqrem Çabej, Meshari i Gjon Buzukut (1555), I-II, Prishtinë: Rilindja 1987, entered by Wolfgang Hock, Berlin 2000-2002; TITUS version by Jost Gippert, Frankfurt a/M, 9.3.2003.
- Çabej, E., *Meshari” i Gjon Buzukut (1555)*. Botim kritik, Pjesa e parë – Hyrje dhe transliterim, Pjesa e dytë – Faksimile dhe transkribim fonetik, Tiranë, 1968.
- Çabej, E., “Hyrje” në: *”Meshari” i Gjon Buzukut (1555)*. Botim kritik, Pjesa e parë – Hyrje dhe transliterim, Tiranë, 1968.
- Çabej, E., “Tekstet e vjetra shqipe dhe disa kriteret rreth botimit të tyre”, BUSHT SSHSH, nr. 2, 1959, ribotuar në: *Studime Gjuhësore VI*, Prishtinë, 1977, f. 329-339.
- Cipo, K., “Një sy rreth dorëshkrimit të Simonit”, *Studime filologjike*, nr. 1, 1964, f. 183-188.
- Demiraj, B. & Bartl, P., La lettera dei frati di Pulati (1761), il suo sfondo storico ed il suo posto nella cultura della scrittura albanese, në: “Nordalbanien – L’Albania del Nord. Linguistisch-kulturhistorische Erkundungen in einem unbekanntem Teil Europas” (Hrsg. Monica Genesin & Joachim Matzinger) Hamburg 2009, f. 63 –79.
- Demiraj, B., *Dictionarium latino-epiroticum (Romae 1635) per R.D. Franciscum Blanchum*, Botime françeskane, Shkodër, 2008.
- Demiraj, B., *Gjon Kazazi dhe “Doktrina” e tij*, ASHAK, Prishtinë, 2006.
- Demiraj, B., “Mallkimi i epirotit (1483)”, *Hylli i Dritës*, nr. 1, 2012.
- Demiraj, B., “Një dorëshkrim ritual në gjuhën tonë” që duhet kërkuar, *Hylli i Dritës*, nr. 1, 2007. Shkodër, f. 30-37.
- Demiraj, B., *Zef Skiroi në kulturën e shkrimit shqip të shek. XVIII*, në: “Studime” 12 [2005], f. 67-97, Prishtinë 2006.
- Demiraj, B., Zur Entdeckung von Buzukus “Missale” in der ersten Hälfte des 18. Jh.s, në: “Nach 450 Jahren. Buzukus Missale und seine Rezeption in unsere Zeit”. Akten der 2. Deutsch-Albanischen Kulturwissenschaftlichen Tagung in München - 14.-15. Oktober

- 2005, në serinë “Albanische Forschungen” vëll. 25, Wiesbaden 2007, f. 289 – 299.
- Dukagjini, Vorf, “Perdorimi i ë n’shkrim t’gjuhës shqype”, *HD*, I (1914), nr. 8.
- Elsie, R., “Albanian alphabet in Greek Script. The eighteenth- and early nineteenth century Orthodox tradition writing”, në *Byzantine and modern Greek Studies*, Birmingham, nr. 15, 1991, f. 20-34.
- Elsie, R., “Albanian literature in the Moslem tradition. Eighteenth- and early nineteenth century Albanian writing in Arabic Script, në: *Oriens. Journal of the International Society for Oriental Research*, Leiden, 1992, nr. 33, f. 287-306.
- Fishta, F., “Gjurmimet e një mueji në Romë”, *HD*, XVI (1940), nr. 10-11, f. 498-515; XVII (1941), nr. 1-2, f. 46-57; 3-5, f. 171-177.
- Gazulli, N., “Gjurmime mbi veprën e Dom Gjon Buzukut”, *HD*, V (1924), nr. 10.
- Gurga, G. (ed.), *Francesco Maria da Lecce, Dittionario Italiano-Albanese (1702)*, botim kritik i dorëshkrimit dhe fjalësi shqip përg. nga G. Gurga, Botime Franceskane, Shkodër, 2009.
- Ismajli, R., *Gjuha shqipe e “Kuvendit të Arbënit”*, Rilindja, Prishtinë, 1985
- Ismajli, R., *Pjetër Budi, Poezi 1618-22*, Studim hyrës (5-45), Transliterim, Komente, Rilindja, Prishtinë, 1986.
- Jokl, N., “Gjyqi i linguistëve të huejë për rreth librit të Buzukut”, *HD*, VI (1930), nr. 3, f. 143-154.
- La Piana, M., *Il catechismo albanese di Luca Matranga (1952), da un antico manoscritto vaticano*, Grottaferrata, 1912.
- La Piana, M., *Il catechismo albanese di Luca Matranga (1952)*, në: *Roma e l’Oriente, Rivista criptoferratense per l’unione delle Chiese*, viti II, vëll. III, prill 1912, Badia Greca di Grottaferrata; viti II, vëll. IV, maj-tetor 1912.
- Lloshi, Xh., *Përkthimi i V. Meksit dhe redaktimi i G. Gjirokastritit 1819-1827*, Onufri, Tiranë, 2012.
- Luka, K., *Letërkëmbimi i firmës tregtare Bianku-Çoba, 1877-1878*, përgatitur nga K. Luka, Ombra GVG, 2000.
- Mandalà M. (ed.), *Luca Matranga. E mbsuame e krështerë*, Edizione critica dei testi manoscritti e a stampa (1592), S. Sciascia Editore, Caltanissetta, 2004.
- Mandalà, M., “Il Dittionario del Da Lecce e i turchismi in albanese (sec. XVII-XVIII)”, në *Albanica* 10, Quaderni di Lingua e Letteratura Albanese, Palermo, 1995.
- Mandalà, M., “L’opera inedita di Francesco Maria Da Lecce: Il *Dittionario italo-albanese (1702)*”, në *Atti del 2 Seminario Internazionale di Studi Albanesi*, a cura di Francesco Altimari, *Quaderni del Dipartimento di Linguistica*, 14, Albanistica, Rende, 1997.

- Mandalà, M., "Il Dittionario del Da Lecce e i turchismi in albanese (sec. XVII-XVIII)", në *Albanica* 10, Quaderni di Lingua e Letteratura Albanese, Palermo, 1995.
- Mandalà, M., "L'opera inedita di Francesco Maria Da Lecce: Il *Dittionario italo-albanese (1702)*", në *Atti del 2 Seminario Internazionale di Studi Albanesi*, a cura di Francesco Altimari, *Quaderni del Dipartimento di Linguistica*, 14, *Albanistica*, Rende, 1997.
- Maynard, Kathleen Lynne, "'I want to buy it' in the albanian Glossary of Arnold von Harff", *Transactions of the Philological Society*, vol. 107: 2 (2009), f. 231-252
- Nosi, L., "Dhaskal Todhri", *Kopështi Letrar, Elbasan*, 1918, nr. 1, f. 13-14; nr. 2 f. 13; nr. 3, f. 8; nr. 4, f. 11; nr. 5, f. 2.
- Omari A. (ed.), *Pjetër Bogdani. Cuneus Prophetarum*, botim kritik, ASHSH IGJL, Mësonjëtorja, Tiranë, 2005.
- Qiriazi, Dh., Thimi Mitko, *Fjalëtore shqip-gërqisht gërqisht-shqip dhe ndihmesa të tjera leksikografike*, Akademia e Shkencave e Shqipërise, Tiranë, 2014.
- Ressuli N., *Il "Messale" di Giovanni Buzuku, Riproduzione e trascrizione*. Città del Vaticano, Biblioteca Apostolica Vaticana, 1958.
- Riza S., "Pesë autorët më të vjetër të shqipes. Krestomati thjesht gjuhësore", në: *Vepra 1*, ASHAK, Prishtinë, 1996.
- Riza, S., "Fillimet e gjuhësisë shqiptare", në: *Vepra 1*, ASHAK, Prishtinë, 1996.
- Riza, S., *Fillimet e gjuhësisë shqiptare*, Prishtinë, 1952.
- Roques M., *Le dictionnaire albanais de 1635*, Paris, 1932.
- Roques, M., *Le dictionnaire albanais de 1635*, Paris, 1932.
- Rrota, J., "Ma të parat kopje të fotografueme të Mesharit të Buzukut në Shqipëni", *Nëndori*, nr. 3, 1955, f. 76-79.
- Rrota, J., "Monumenti më i vjetri i Gjuhës Shqype. D. Gjon Buzuku (1555)", *HD*, VI (1930), nr. 1, f. 33-53; "Prej librit të Buzukut (1555)", VI (1930), nr. 2, f. 108-114; VI (1930), nr. 4, f. 231-238; VI (1930), nr. 5, f. 292-300; VI (1930), nr. 10, f. 569-576; VI (1930), nr. 12, f. 671-680.
- Rrota, J., "Per historin e alfabetit shqyp", *HD*, VII (1931), nr. 12, f. 676-684; VIII (1932), nr. 3, f. 123-129; VIII (1932), nr. 5, f. 223-230; VIII (1932), nr.7-8, f. 341-350; IX (1933), nr. 9-10, f. 464-474; IX (1933), nr. 11, f. 514-518; X (1934), nr. 1, f. 15-21; X (1934), nr. 3, f. 140-147; X (1934), nr. 11, f. 529-535; XI (1935), nr. 1, f. 8-19; XII (1936), nr. 2, f. 61-67; XII (1936), nr. 4, f. 171-176.
- Rrota, J., "Per rreth botimit të dorëshkrimit shqyp të shekullit XIV", *HD*, VI (1930), nr. 7-8, f. 402-411.
- Rrota, J., "Shkrimtari më i vjetri i Italo-Shqyptarvet, Lukë Matranga (1592)", *HD*, VII (1931), nr. 8, f. 505-522.

- Sala, Sh., *Fjalori italisht-greqisht-shqip i Thimi Mitkos*, I Dorëshkrimi origjinal, II Transliterimi dhe fjalësi shqip, Westprint, Tiranë, 2013.
- Schirò, P. e Petrotta, G., “Il più antico testo di lingua albanese” (Trascrizione fonetica con note e osservazioni grammaticali di Mons. Paolo Schirò e riproduzione del testo dell’ *Editio princeps* con introduzione di Gaetano Petrotta), *Rivista indo-greco-italica*, XVI/I-II, 1932, f. 41-67; Po ata, “Il più antico testo di lingua albanese. I testi biblici del Buzuku”, *RIGI*, XVI/III-IV, 1932, f. 103-122; Po ata, *RIGI* XVII/1-2, 1933, f. 89-99.
- Shuteriqi, Dh., “Anonimi i Elbasanit. Shkrimi shqip në Elbasan në shekujt XVIII-XIX”, *Buletin i Institutit të Shkencave*, Tiranë 1949, 1, f. 33-54.
- Shuteriqi, Dh., “Dhaskal Todhri”, *Buletin i Institutit të Shkencave*, nr. 4, 1954.
- Shuteriqi, Dh., “Shkrime të Dhaskal Todhrit dhe të pasardhësve të tij elbasanas, shoqëruar me fjalorin e shkrimeve të Todhrit”, *Buletin i Shkencave Shoqërore*, nr. 1, 1951, f. 165-197.
- Shuteriqi, Dh., *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*, Akademia e Shkencave, Tiranë 1976.
- Shuteriqi, Dh., *Tekstet shqipe dhe shkrimi i shqipes në vitet 879-1800*, ASHSH, IGJL, Tiranë, 2005.
- Sulejmani, F., *E mbsuame e krështerë e Lekë Matrëngës*, Rilindja, Prishtinë, 1979.
- Suta, B., *Faqe të panjohura nga vepra e Pjetër Budit (1618-1622)*, Onufri, Tiranë, 2016.
- Svane, G. (ed.), *Peter Budi, Dottrina Christiana (1618)*. With a transcription into modern orthography and a concordance prepared by Gunnar Svane. Institut for Lingvistik, Aarhus Universitet, Århus, 1985.
- Svane, G. (ed.), *Peter Budi, Rituale Romanum (1621)*. With a transcription into modern orthography and a concordance prepared by Gunnar Svane. Institut for Lingvistik, Aarhus Universitet, Århus, 1986.
- Svane, G. (ed.), *Peter Budi, Speculum Confessionis (1621)*, With a transcription into modern orthography and a concordance prepared by Gunnar Svane. Institut for Lingvistik, Aarhus Universitet, Århus, 1986.
- Svane, G. “Formimi i gjuhës letrare shqipe siç paraqitet në “Pasqyrën e të rrëfymit” të Budit (1621)”, *Studime Filologjike*, nr. 3, 1982, f. 115-132.
- Svane, G., “How to read “Speculum Confessionis?””, *Studia Albanica*, nr. 1, 1980, f. 121-179.
- Zamputi, I., “Dorëshkrimi i anonimit të Elbasanit, Transliterim, transkriptim dhe koment”, *Buletin i Institutit të Shkencave*, Tiranë, 1951.
- Zamputi, I., “Disa shënime rreth alfabetit të dorëshkrimit të Anonimit elbasanas”, *Buletin i Institutit të Shkencave*, Tiranë 1949.

SUMMARY

THE PHILOLOGY OF ALBANIAN TEXTS AND ITS DEVELOPMENT UNTIL NOWADAYS: AN OVERVIEW

The article presents an overview of the current state of Albanian textual philology, with a focus on older Albanian texts (XVI-XVIII centuries).

In the first part of the article, after briefly explaining the dennotations of the term *philology* in Albanian linguistics, the study takes a historical look at the beginnings of Albanian philology with the discovery of the first book written in Albanian, Gjon Buzuku's Missale (1555), by archbishop Gjon Nikollë Kazazi (1743). A contemplation of the publishing activity of old texts in the years `30-`40 is then presented, followed by later work in the `50s, ending with the rich publishing activity of recent years in the field of textual philology of Albanian texts.

In the second part of the article, the author focuses on the implementation of scientific philological methods in recent critical editions, which are created according to the principles of modern philology and the ecdotic method, implemented by the Albanian linguist Eqrem Çabej in his critical edition of Buzuku's Missale.

